



Pranuar / Dorezuar Prenjara / Predata Received / Delivered	28.12.2023	3	viti god year
Organ / Objekta Organ / Jednina Org / Objekt	In Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
820051000	7714/2023		1/9



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1349/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1349/2023 të datës 30.10.2023 të parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit Komuna e Kamenicës, në çështjen juridike "Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 28.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1349/2023 e datës 30.10.2023 e parashtruar nga ankuesi

Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokolli 36908 i datës 31.10.2023 dhe vendimi me numër protokolli 36907 i datës 31.10.2023 të Kryesuesit të Komisionit të Komunës së Kamenicës.

A r s y e t i m

(tani e tutje referuar si ankuesi), i cili sipas shkresave të lëndës është kandidatë në procedurën e rekrutimit për grupin Specialistë Ligjor, gjegjësisht për pozitën "Zyrtar Ligjor 2, në zyrën e Kryetarit zyra ligjore në Komunën e Kamenicës, për një (1) pozitë si dhe kandidatë në procedurën e rekrutimit për grupin Specialistë Ligjor, gjegjësisht për

pozitën "Zyrtar Ligjor 1, në Drejtorinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Komunën e Kamenicës për një (1) pozitë. Ankuesi më datë 30.10.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokolli 6759/2023, me pretendimin ankimor kundër njoftimit të datës 20.10.2023 për grupin Specialist Ligjor për pozitën Zyrtar Ligjor zyra Ligjore dhe për pozitën Zyrtar Ligjor Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Komunën e Kamenicës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 17.11.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Kamenicës, ndërsa Këshilli më datë 23.11.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Kamenicës, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin me numër VK/2023 me datë 12.12.2023 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankuesit edhe për dhjetë (10) ditë pune.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokolli 6779/2023 të datës 30.10.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin nga R.A për [ankesa.kpmshck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmshck@rks-gov.net) e datës 30.10.2023; Konkursi me emrin e grupit Specialist Ligjor me numër reference Nr.Ref. RN00012269 i datës 07.08.2023; Konkursi me emrin e grupit Specialist Ligjor me numër Nr.Ref. RN00012242 i datës 03.08.2023; Verifikimin paraprak Specialist ligjor në Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural me numër Nr.Ref. RN00012269 të datës 18.09.2023; Verifikimin paraprak Specialist Ligjor në Zyren Ligjore me numër Nr.Ref. RN00012242 të datës 18.09.2023; Njoftim Lista e Rezultateve përfundimtare të vlerësimit, për grupi Specialist Ligjor Nr.Ref. RN00012269, Zyrtar Ligjor Drejtoria e Bujqësisë , Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të datës 20.10.2023; Njoftim Lista e Rezultateve përfundimtare të vlerësimit, për grupi Specialist Ligjor Nr.Ref. RN00012242, Zyrtar Ligjor/Zyra Ligjore të datës 20.10.2023; Ankesën e ankuesit drejtuar Komisionit të Pranimit-Komuna e Kamenicës për Konkursin e datës 28.08.2023; Ankesën e ankuesit drejtuar Komisionit të Pranimit-Komuna e Kamenicës për Konkursin e datës 24.08.2023; E-mailin nga R.A. për [ankesa.kpmshck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmshck@rks-gov.net) të datës 31.10.2023; E-mailin nga R.A. për [ankesa.kpmshck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmshck@rks-gov.net) të datës 30.10.2023; E-mail nga [ankesa.kpmshck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmshck@rks-gov.net) për R.A i datës 30.10.2023; Vendimin me numer protokolli Nr. 36908 të datës 31.10.2023; Vendimin me numër protokolli Nr.36907 të datës 31.10.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 17.11.2023; Përgjigje në ankesë e datës 23.11.2023; Vendim i KPMSSHCK me numër protokolli 7424/2023 i dates 12.12.2023; Lista e aplikantëve nga SIMBNJ me numër reference Nr.Ref. RN00012242; Verifikimi paraprak Specialist Ligjor zyra ligjore i datës 12.09.2023; Vendim për formimin e komisionit të pranimit me numër protokolli 16897 i datës 19.05.2023; Akt emërim i H.D i datës 20.03.2020; Akt emerim i K.K i datës 22.07.2011; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit të F.K të datës

30.12.2013; Akt emerim i F.K. i datës 21.09.2011; Akt emerim i Sh.L i datës 22.08.2022; Vendim me numër protokoll 14672 i datës 11.05.2022; Renditja përfundimtare e kandidatëve nga SIMBNJ me numër reference Nr. Ref. RN00012242; Rezultatet përfundimtare të vlerësimit, për grupi Specialistë Ligjor Nr. Ref. RN00012242, Zyrtar Ligjor/Zyra Ligjore të datës 01.11.2023; Aplikacioni i N.Sh i datës 28.08.2023; Diplomë nga Universiteti Prishtinës "Hasan Prishtina" e N.K-Sh me numër Nr.143 të datës 29.01.2016; Diplomë nga Universiteti Prishtinës "Hasan Prishtina" e N.SH me numër Nr.1714 të datës 22.02.2018; Certifikatë nga KCSF për N.Sh të muajit Qershor 2018; Certifikatë nga IOM për N.Sh të muajit Shkurt 2020; Certifikatë nga Gjykata Themelore Gjilan për N.Sh të datës 27.12.2016; Vërtetim nga organizata YESZ-ecoz për N.Sh. të datës 14.12.2019; Vërtetim nga Komuna e Kamenicës për N.Sh me numër protokoll 4856 të datës 24.02.2021; Letër Referencë nga APRK për N.Sh. me numër Nr.04-1102-2023 të datës 28.08.2023; Letërnjoftimi i N.Sh; Certifikatë mbi dënimet penale për N.Sh të datës 23.08.2023; Aplikacioni i R.R i datës 28.08.2023; Diploma për kryerjen e Shkollës së Mësme të Lartë-Gjimnazit të R.R me numër protokoll 847 të datës 16.09.2014; Diplomë nga Universiteti Publik "Kadri Zeka" për R.R me numër Nr.237 të datës 14.10.2020; Kontratë pune për kohë të caktuar nga RDA për R.R të datës 14.11.2022; Letërnjoftimi i R.R; Certifikatë nga Gjykata Themelore Gjilan për R.R e datës 02.03.2022; Certifikatë nga ojç dardania press për R.R me numër Nr.15/2023 e datës 07.05.2023; Certifikatë nga ojç dardania press për R.R me numër Nr.29/2023 e datës 17.08.2022; Certifikatë mbi dënimet penale për R.R të datës 28.08.2023; Aplikacioni i R.A i datës 24.08.2023; Diplomë nga Universiteti "Kadri Zeka" për R.A me numër Nr.76 të datës 25.07.2018; Diplomë nga Universiteti "Haxhi Zeka" për R.A me numër Nr.21 të datës 14.12.2021; Certifikatë nga IOM për R.A për periudhën Dhjetor 2021-Mars 2022; Njoftim me numër reference AN.nr.36/2019 të datës 14.02.2019; Vërtetim nga Gjykata Themelore Gjilan për R.A me numër 368/2019 të datës 29.10.2019; Certifikatë nga IAP për R.A të datës 21.06.2023; Referencë nga Sh.M për R.A; Referencë nga S.M për R.A; Letërnjoftimi i R.A; Certifikatë mbi dënimet penale për R.A të datës 21.08.2023; Përgjigje në ankesë i datës 24.11.2023; Lista e aplikantëve nga SIMBNJ me numër reference Nr.Ref. RN00012269; Verifikimin paraprak Specialist Ligjor Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me numër reference Nr. Ref. RN000012269 të datës 12.09.2023; Njoftimin me numër reference Nr.Ref. RN00012269 të datës 20.10.2023; Rezultatet përfundimtare të vlerësimit, për grupi Specialistë Ligjor Nr. Ref.RN00012269, Zyrtar Ligjor Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të datës 01.11.2023; Renditja përfundimtare e kandidatëve me numër referencë RN00012269; Aplikacioni i R.A i datës 28.08.2023; Aplikacioni i N.Sh. i datës 28.08.2023

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, *është e pabazuar sepse:*

Kolegji i Këshillit nga provat e administruara të lëndës ka gjetur se Komuna e Kamenicës, me datë 03.08.2023 ka shpallur konkursin për Specialist Ligjor, për pozitën "Zyrtar Ligjor 2" zyra ligjore zyra e kryetarit në Komunën e Kamenicës për një (1) pozitë ku afati për aplikim ka qenë nga data 24.08.2023–31.08.2023 me numër të referencës RN00012242.

Ankuesi bazuar në shkresat e lëndës ka marrë pjesë në të gjitha fazat lidhur me procedurën e zhvilluar për pozitën "Zyrtar Ligjor 2" në Komunën e Kamenicës i cili në bazë të njoftimit të datës 20.10.2023 të Komunës së Kamenicës ka marrë gjithsejt 73.6 pikë total. Ndërsa bazuar në njoftimin e Komunës së Kamenicës të datës 01.11.2023 të datës 01.11.2023, ankuesi nuk ka arritur pikët për të qenë kandidatë fitues. I pakënaqur me njoftimin e Komunës së Kamenicës të datës 20.10.2023 ankuesi ka parashtruar ankesë tek Komisioni i Pranimit. Ndërsa sipas Vendimit me numër protokolli 36907 të datës 31.10.2023 të Kryesuesit së Komisionit të Pranimit të Komunës së Kamenicës, rezulton se ankuesit i është refuzuar ankesa si e pa bazuar duke e lënë në fuqi rezultatin e vlerësimit përfundimtar.

Ankuesi i pakënaqur, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimin ankimor se ndaj tij nuk është bërë vlerësim real me pikët e fituara të vlerësuar nga Komisioni i Pranimit.

Kolegji i Këshillit në kontekst të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit analizoi kriteret e konkursit për pozitën përkatëse të punës dhe konstatoi se kriteret formale për pozitën e punës Specialist Ligjor për pozitën "Zyrtar Ligjor 2", në Komunën e Kamenicës për një (1) pozitë me numër të referencës RN00012242, Kërkesat e përgjithshme formale kanë qenë:

Arisimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve;

Kulifikime të posaçme formale: Fakulteti Juridik;

Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 1 (një) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar së pas zhvillimit të procedurave të rekrutimit, Komisioni i Pranimit për Institucionet e Administratës Shtetërore, si kandidatë të suksesshëm për pozitën për Specialist i Arsimit, për pozitën "Zyrtar Ligjor 2", në Komunën e Kamenicës, për një (1) pozitë, sipas njoftimit të Komunës së Kamenicës të datës 01.11.2023 kandidatja e parë me më së shumti pikë është kandidatja të cilën kandidate komisioni e ka vlerësuar me gjithsejtë tetëdhjetë e pesë pikë gjashtë (85.6), ndërsa kandidati i dytë me më së shumti pikë është kandidati me gjithsejtë tetëdhjetë e një pikë dy pikë (81.2) pikë gjithsejtë dhe kandidati i tretë ankuesi me gjithsejtë shtatëdhjetë e tre pikë gjashtë pikë (73.6).

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson se Komisioni i Pranimit ka bërë vlerësimin e ankuesit dhe kandidatëve të tjerë sipas procedurave sepse vlerësimi i kandidatëve përfshin, sipas radhës: 2.1. vlerësimin nëpërmjet një testimi me shkrim; 2.2. vlerësimin e jetëshkrimit /CV, dhe 2.3. vlerësimin nëpërmjet një interviste me gojë, siç parashihet me nenin 16 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ndërsa nga të gjitha vlerësimet e ndërlidhura me nenin 21, 22, 23 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe

Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me nenin 24 të kësaj rregulloreje, përcaktohet se: *"Shuma e pikëve të përfituara nga se cili kandidat në se cilën nga hapat e vlerësimit, japin vlerësimin përfundimtar të kandidatit"*. Bazuar në këtë publikimi i njoftimit të Komunës së Kamenicës i datës 01.11.2023 dhe i renditjes përfundimtare të kandidatëve është bërë në pajtim me nenin 9 dhe paragrafin 2 të nenit 25 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: *"2. Kandidatët që janë vlerësuar me shtatëdhjetë (70) pikë e më shumë, janë kandidatë fitues"*, mirëpo meqë në këtë konkurs janë kërkuar një (1) vend pune, atëherë kandidatët e renditur me më së shumti pikë që në bazë të listës së renditjes përfundimtare të kandidatëve janë kandidati i parë me më së shumti pikë është kandidatja e cila ka marrë gjithsejtë tetëdhjetë e pesë pikë gjashtë (85.6), ndërsa kandidati i dytë me më së shumti pikë është kandidati me gjithsejtë tetëdhjetë e një pikë dy pikë (81.2) pikë gjithsejtë dhe kandidati i tretë ankuesi me gjithësejtë shtatëdhjetë e tre pikë gjashtë pikë (73.6), si rrjedhojë e kësaj Kolegji i Këshillit ka konstatuar se emërohen në këtë pozitë sipas nenit 26 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"Kandidati fitues, sipas renditjes, duke filluar nga ai me më shumë pikë, njoftohet nga njësia përgjegjëse për pozitën e lira dhe ka të drejtën të përzgjedhë çdo pozitë të lirë të Grupit dhe të emërohet në të, për të cilin është zhvilluar procedura e pranimit, si dhe në çdo pozitë tjetër të lirë të të njëjtit Grup, që krijohet e lirë deri në një (1) vit nga shpallja publike e listës të kandidatëve fitues"*.

Kolegji i Këshillit pasi ka analizuar kriteret e konkursit lidhur me përvojën e punës për pozitën *"Zyrtar Ligjor 2"* po ashtu ka konstatuar se kriteret janë në pajtim me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikim e vendeve të punës në shërbimin civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka analizuar me kujdes pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me vlerësimin nga Komisioni i Vlerësimit dhe ka konstatuar se vlerësimi nga ana e Komisionit është bërë në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Ndërsa Kolegji i Këshillit ka konstatuar se sipas njoftimit për kandidatët fitues në bazë të Njoftimit të datës 01.11.2023 është përzgjedhur e cila ka marrë gjithsejtë tetëdhjetë e pesë pikë gjashtë (85.6). Kolegji i Këshillit ka konstatuar se kandidatja e përzgjedhur posedon këto dokumente: Aplikacioni i N.Sh i datës 28.08.2023; Diplomë nga Universiteti Prishtinës *"Hasan Prishtina"* e N.K-Sh me numër Nr.143 të datës 29.01.2016; Diplomë nga Universiteti Prishtinës *"Hasan Prishtina"* e N.SH me numër Nr.1714 të datës 22.02.2018; Certifikatë nga KCSF për N.Sh të muajit Qershor 2018; Certifikatë nga IOM për N.Sh të muajit Shkurt 2020; Certifikatë nga Gjykata Themelore Gjilan për N.Sh të datës 27.12.2016; Vërtetim nga organizata YESZ-ecoz për N.Sh. të datës 14.12.2019; Vërtetim nga Komuna e Kamenicës për N.Sh me numër protokollit 4856 të datës 24.02.2021; Letër Referencë nga APRK për N.Sh. me numër Nr.04-1102-2023 të datës 28.08.2023; Letërnjoftimi i N.Sh; Certifikatë mbi dënimet penale për N.Sh të datës 23.08.2023;

Në bazë të të gjitha shkresave të lëndës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke i shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të ankuesit, konstaton se procedura për

pozitën e punës Specialist Ligjor për pozitën "Zyrtar Ligjor 2", në Komunën e Kamenicës për një (1) pozitë me numër të referencës RN00012242, me rastin e zhvillimit të procedurës së rekrutimit deri tek përzgjedhja përfundimtare e kandidatëve ka vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafi 1, 2 dhe 3 ligji nr. 06/1 - 114 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se; 1. Pranimi në detyrë i nëpunësit civil, bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve. 2. Pranimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës profesional, transparent e të drejtë, që garanton mundësi të barabarta për kushte të barabarta dhe përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar për kryerjen e detyrave përkatëse, duke garantuar përfaqësim minimal të komuniteteve dhe të gjinive, 3. Procesi përzgjedhës, sipas paragrafit 2 të këtij neni, bazohet në vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve, nëpërmjet një konkurrimi të përgjithshëm, që përfshin një testim me shkrim dhe me gojë, si dhe çdo formë tjetër të përshtatshme të vlerësimit, si dhe në pajtim me nenin 4, paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet 1. Pranimi dhe avancimi në karrierë në shërbimin civil bazohet në parimet e mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë e proporcional gjinor dhe të pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë. 2. Nëpunësit civil pranohen dhe avancohen në karrierë në bazë të meritës të vlerësuar në bazë të një procedure konkurruese dhe transparente, të përcaktuara në bazë të Ligjit dhe akteve përkatëse nënligjore.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e pabazuar sepse:

Kolegji i Këshillit nga provat e administruara të lëndës ka gjetur se Komuna e Kamenicës, me datë 07.08.2023 ka shpallur konkursin për Specialist Ligjor, për pozitën "Zyrtar Ligjor 1" në Drejtorinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Komunën e Kamenicës për një (1) pozitë ku afati për aplikim ka qenë nga data 28.08.2023-04.09.2023 me numër të referencës RN00012269. Ankuesi bazuar në shkresat e lëndës ka marrë pjesë në të gjitha fazat lidhur me procedurën e zhvilluar për pozitën "Zyrtar Ligjor 1" në Komunën e Kamenicës i cili në bazë të njoftimit të datës 20.10.2023 të Komunës së Kamenicës ka marrë gjithsejtë 77.2 pikë total. Ndërsa bazuar në njoftimin e Rezultateve përfundimtare të vlerësimit të Komunës së Kamenicës të datës 01.11.2023, ankuesi nuk ka arritur pikët për të qenë kandidatë fitues. I pakënaqur me njoftimin e Komunës së Kamenicës të datës 20.10.2023 ankuesi ka parashtruar ankesë tek Komisioni i Pranimit. Ndërsa sipas Vendimit me numër protokollit 36908 të datës 31.10.2023 të Kryesuesit së Komisionit të Pranimit të Komunës së Kamenicës, rezulton se ankuesit i është refuzuar ankesa si e pa bazuar duke e lënë në fuqi rezultatin e vlerësimit përfundimtar.

Ankuesi i pakënaqur, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimin ankimor se ndaj tij nuk është bërë vlerësim real me pikët e fituara të vlerësuar nga Komisioni i Pranimit.

Kolegji i Këshillit në kontekst të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit analizoi kriteret e konkursit për pozitën përkatëse të punës dhe konstatoi se kriteret formale për

pozitën e punës Specialist Ligjor për pozitën "Zyrtar Ligjor 1", në Drejtorinë e Bujqësisë Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural në Komunën e Kamenicës për një (1) pozitë me numër të referencës RN00012242, Kërkesat e përgjithshme formale kanë qenë:

Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë Fakulteti Juridik më së paku 3 vite të studimeve;

Përvoja e punës e kërkuar: Nuk kërkohet;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar së pas zhvillimit të procedurave të rekrutimit, Komisioni i Pranimit për Institucionet e Administratës Shtetërore, si kandidatë të suksesshëm për pozitën për Specialist Ligjor, për pozitën "Zyrtar Ligjor 1", në Drejtorinë e Bujqësisë Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural në Komunën Kamenicës, për një (1) pozitë, sipas njoftimit të Komunës së Kamenicës të datës 01.11.2023 kandidatja e parë me më së shumti pikë është kandidatja të cilën kandidate komisioni e ka vlerësuar me gjithsejtë (86.2) pikë, ndërsa kandidati i dytë ankuesi me gjithsejtë (77.2) pikë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson se Komisioni i Pranimit ka bërë vlerësimin e ankuesit dhe kandidatëve të tjerë sipas procedurave sepse vlerësimi i kandidatëve përfshin, sipas radhës: 2.1. vlerësimin nëpërmjet një testimi me shkrim; 2.2. vlerësimin e jetëshkrimit /CV, dhe 2.3. vlerësimin nëpërmjet një interviste me gojë, siç parashihet me nenin 16 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ndërsa nga të gjitha vlerësimet e ndërlidhura me nenin 21, 22, 23 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me nenin 24 të kësaj rregulloreje, përcaktohet se: **"Shuma e pikëve të përfituara nga se cili kandidat në se cilën nga hapat e vlerësimit, japin vlerësimin përfundimtar të kandidatit"**. Bazuar në këtë publikimi i njoftimit të Komunës së Kamenicës i datës 01.11.2023 dhe i renditjes përfundimtare të kandidatëve është bërë në pajtim me nenin 9 dhe paragrafin 2 të nenit 25 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: **"2. Kandidatët që janë vlerësuar me shtatëdhjetë (70) pikë e më shumë, janë kandidatë fitues"**, mirëpo meqë në këtë konkurs janë kërkuar një (1) vend pune, atëherë kandidatët e renditur me më së shumti pikë që në bazë të listës së renditjes përfundimtare të kandidatëve janë kandidati i parë me më së shumti pikë është kandidatja e cila ka marrë gjithsejtë (86.2) pikë, ndërsa kandidati i dytë ankuesi me gjithsejtë (77.2) pikë, si rrjedhojë e kësaj Kolegji i Këshillit ka konstatuar se emërohen në këtë pozitë sipas nenit 26 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: **"Kandidati fitues, sipas renditjes, duke filluar nga ai me më shumë pikë, njoftohet nga njësia përgjegjëse për pozitën e lira dhe ka të drejtën të përzgjedhë çdo pozitë të lirë të Grupit dhe të emërohet në të, për të cilin është zhvilluar procedura e pranimit, si dhe në çdo pozitë tjetër të lirë të njëjtit Grup, që krijohet e lirë deri në një (1) vit nga shpallja publike e listës të kandidatëve fitues"**.

Kolegji i Këshillit pasi ka analizuar kriteret e konkursit lidhur me përvojën e punës për pozitën "Zyrtar Ligjor 1" në Drejtorinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural po ashtu ka konstatuar se kriteret janë në pajtim me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikim e vendeve të punës në shërbimin civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka analizuar me kujdes pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me vlerësimin nga Komisioni i Vlerësimit dhe ka konstatuar se vlerësimi nga ana e Komisionit është bërë në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Ndërsa Kolegji i Këshillit ka konstatuar se sipas njoftimit për kandidatët fitues në bazë të Njoftimit të datës 01.11.2023 është përzgjedhur \_\_\_\_\_ e cila ka marrë gjithsejtë tetëdhjetë e pesë pikë gjashtë (85.6). Kolegji i Këshillit ka konstatuar se kandidatja e përzgjedhur posedon këto dokumente: Aplikacioni i N.Sh i datës 28.08.2023; Diplomë nga Universiteti Prishtinës "Hasan Prishtina" e N.K-Sh me numër Nr.143 të datës 29.01.2016; Diplomë nga Universiteti Prishtinës "Hasan Prishtina" e N.SH me numër Nr.1714 të datës 22.02.2018; Certifikatë nga KCSF për N.Sh të muajit Qershor 2018; Certifikatë nga IOM për N.Sh të muajit Shkurt 2020; Certifikatë nga Gjykata Themelore Gjilan për N.Sh të datës 27.12.2016; Vërtetim nga organizata YESZ-ecoz për N.Sh. të datës 14.12.2019; Vërtetim nga Komuna e Kamenicës për N.Sh me numër protokollit 4856 të datës 24.02.2021; Letër Referencë nga APRK për N.Sh. me numër Nr.04-1102-2023 të datës 28.08.2023; Letërnjoftimi i N.Sh; Certifikatë mbi dënimet penale për N.Sh të datës 23.08.2023;

Në bazë të të gjitha shkresave të lëndës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke i shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të ankuesit, konstaton se procedura për pozitën e punës Specialist Ligjor për pozitën "Zyrtar Ligjor 1", në Drejtorinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Komunën e Kamenicës për një (1) pozitë me numër të referencës RN00012269, me rastin e zhvillimit të procedurës së rekrutimit deri tek përzgjedhja përfundimtare e kandidatëve ka vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafi 1, 2 dhe 3 ligji nr. 06/1 - 114 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se; 1. Pranimi në detyrë i nëpunësit civil, bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve. 2. Pranimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës profesional, transparent e të drejtë, që garanton mundësi të barabarta për kushte të barabarta dhe përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar për kryerjen e detyrave përkatëse, duke garantuar përfaqësim minimal të komuniteteve dhe të gjinive, 3. Proces i përzgjedhës, sipas paragrafit 2 të këtij neni, bazohet në vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve, nëpërmjet një konkurrimi të përgjithshëm, që përfshin një testim me shkrim dhe me gojë, si dhe çdo formë tjetër të përshtatshme të vlerësimit, si dhe në pajtim me nenin 4, paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet 1. Pranimi dhe avancimi në karrierë në shërbimin civil bazohet në parimet e mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë e proporcional gjinor dhe të pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë. 2. Nëpunësit civil pranohen dhe avancohen në



karierë në bazë të meritës të vlerësuar në bazë të një procedure konkurruese dhe transparente, të përcaktuar në bazë të Ligjit dhe akteve përkatëse nënligjore.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.1349/2023

Çlirim Zeka

  
Procesmbajtës



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Kamenicës;
- Udhëheqësitë të Personelit në Komunën e Kamenicës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.